



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

## Komuna e Klinës

### Kuvendi i Komunës

01Nr. 6 - 6154 2025

Klinë 03.03.2025

### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur me datë 31. 01. 2025, në sallën e Kuvendit, nisur nga ora 10:00.

Pjesëmarrës në mbledhje, kryetari i komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj, nënkyetarja e komunës, znj. Marqe Selmanaj, përfaqësues të OSBE, anëtarë të kuvendit, media dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi kryesuesi I kuvendit, z. Fadil Gashi I cili përshëndeti gjithë të pranishmit. Konfirmoj se prezent janë 24 anëtarë të kuvendit. Kryesuesi hapi debat rrëth rendit të ditës.

**Me 24 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA Rendi I Ditës.**

#### Pika 1 e Rendit të Ditës: Arsyetimi I mungesave

Mungojnë: Arta Pantina, Ilir Hoti, Besiana Gashi

**Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit.**

**Me 24 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

#### Pika 3 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe përgjigje

**z. Asdren Ramadani:** Përshëndetje. Nga hyrja e QKMF dhe deri tek kthesa e "Sefermanve" Janë disa gropë dhe rruga është në gjendje të mjerueshme, kur do ti mbushni ato gropë. Pyetje tjetër: Rruga shëtitore përgjatë shratit të lumit "Drini I Bardhë" nuk ka asnjë pushimore për të moshuarit veçanti. A mendoni se duhet të vendosni ndonjë pushimore në këtë shëtitore.

**z. Qendrim Millaku, drejtor I SHPE:** Përshëndetje të gjithëve. Rruga që përmende më herët po ka disa gropë, këtë vit parashihet mbulimi I kësaj rruge me një shtresë të re asfalti. Ndërsa për pushimore e dij që shumë shpejt do të vendosen.

**z. Esat Raci:** Përshëndetje të gjithëve. Ka një kohë që kompania “Ambienti” ka zëvendësuar kontejnerët e mëdhenj me disa më të vegjël gjë që ka pakënaqësi nga banorët sepse janë shumë të vogla.

**z. Qendrim Millaku, drejtor I SHPE:** E vërtetë por kompania në fjalë është në procedurë prokurimi për furnizim me kontejnerë 120L dhe 240 L dhe posa të kryhet kjo procedurë atëherë ku ka kërkesa nga qytetarët do të vendosen.

**z. Ndrec Zefaj:** Përshëndetje të gjithëve. Kam një pyetje për ekzekutivin që ka të bëjë me KF ”Dukagjini”. E dimë që komuna e ka përkrahë me 32 mijë euro këtë klub por kjo është e pa mjaftueshme për garat ku ky ekip bënë pjesë. Në komunat e tjera klubet e super ligës përkrahen shumë më shumë. Kërkesë e imja është që të rritet kjo përkrahje, mbështetjen e kuvendarëve të LDK do ta keni.

**z. Zenun Elezaj, kryetar komune:** Në lidhje me subvencionet ne veç se e kemi aprovuar buxhetin. Kemi diku te 100 mijë euro që I mbështesim të gjitha OJQ. Kur e bëjmë thirrjen është me shumën maksimale. Këtë vit është menduar nga drejtoria e kulturës që të shkohet në 40 mijë euro por kjo bëhet vetëm përmes thirrjes publike. Në të ardhmen shohim se a ka ndonjë tepricë në buxhet që ta rrisim përkrahjen edhe më shumë.

**Znj. Blerina Gashi :** Kam një shqetësim te banorëve të lagjes ”Demaj” te fshatit Gjurgjevik. Janë disa shtylla elektrike që para disa kohe janë djegur dhe po e rrezikojnë jetën e banorëve. A keni ndonjë marrëveshje me KEDS që të ndërhyhet.

**z. Zenun Elezaj, kryetar I komunës:** Përgjegjësia e komunës këtu është zero por nëse është rrezik do të shkoj inspektorati komunal dhe do të bëjë një proces, më pastaj është më I shpejt intervenimi I KEDS.

**z. Zafer Gashi:** Përshëndetje. Kryetar na intereson çështja e ujit të pijshëm. A ka përfunduar projekti, a janë kry testet e lajmëruara, a janë rrit kapacitetet për ujë të pijshëm dhe a është vënë në shfrytëzim. Ka kërkesa nga banorët e Kërrnicës, një rrugë e prishur atje, kanë problem edhe me ujërat e zeza. Po ashtu Lagja e ”Xhamisë” në Sferkë, rruga është prishur nga kamionët që juan keni shtruar oborret njerëzve, a mendoni që ta rregulloni këtë rrugë që e keni prishur.

**z. Zenun Elezaj, kryetar I komunës:** Fundërruesi është në procesin e lidhjes me fabrikën. Siç jam I informuar kanë dalë disa problem me valvulet për të cilat janë në fazat e fundit të rregullimit. Rruga në Kerrnicë, qytetari le ta bëjë një kërkesë dhe me mundësitë buxhetore do të intervenojmë. Ndërsa rruga kryesore e kam parë edhe unë është në gjendje të pakëndshme por që drejtoria për shërbime publike do ta merr përsipër që të sanohet. Është paraparë edhe riparimi I asaj pjese në drejtim të Perqevës.

**Znj. Marigona Raci:** Përshëndetje. Duke e pasur parasysh rrezikun e mungesave të shenjave të komunikacionit në vendkalimet e hekurudhës, a mund at dijë pse ende nuk janë vendosur këto shenja në komunën tonë.

**z. Faruk Smajli, drejtor I inspektoratit:** Përshëndetje. Nuk po e dij saktësish vendin se ku nuk ka shenja paralajmëruese të tilla sepse vitin e kaluar janë vendosur mbi 120 shenja për vendkalimet hekurudhore. Ma adreso saktësish vendin.

**Znj. Marigona Raci:** Tek fshati Ujmir, është e nevojshme që të bëhet inspektimi sepse nuk janë shenjet e duhura dhe vendet e duhura ku janë vendosur ato shenja.

**z. Faruk Smajli, drejtor I inspektoratit:** Në rregull, ju ftoj edhe juve që bashkërisht ta vizitojmë atë pjesë.

**z. Tunë Dedaj:** Përshëndetje të gjithëve. Unë dua ta përkrah kërkesën e kolegut nga LDK për rritjen e përkrahjes financiare jo vetëm për kF'Dukagjni" por për të gjitha klubet sportive. Po ashtu kam një kërkesë nga një qytetar për drejtorin e urbanizimit por pasi që nuk është këtu po ju drejtohem juve kryetar: Gjon Gjinaj ka bërë një kërkesë për shtrim të asfaltit në rrugën e tyre, kërkesën e ka bërë tek drejtori që jua ka kthyer përgjigjen pozitive që do të kryhet Brenda vitit që shkoj por ende nuk është kthyer. Kërkoj nga ju që të kryhet ajo rrugë.

**z. Kushtrim Haliti:** Përshëndetje. Kam një pyetje për drejtorin e shëndetësisë. A I menaxhon dikush ndërrimin e natës sepse ju kam thirrur edhe juve në telefon, me 9 janar, ka pasur shumë pacientë në QKMF, aty ka qenë vetëm doktori kujdestar dhe një teknik, të tjerët kanë qenë në kafe. E kam pasur nënën në emergjencë për të bërë një EKG, ata shtyheshin se kush ta bëjë derisa vet doktoresha e ka bërë vet. A I menaxhon dikush këta apo bëjnë çfarë duan ata në orar të punës?

**z. Agron Bacaj, drejtor I shëndetësisë:** Unë jam interesuar për këtë rast dhe I kam verifikuar kamerat. Atë moment nuk ka pasur fluks pacientësh. Disa nga punëtorët kanë qenë duke pijë kafe por brenda objektit dhe e fundit, EKG e bënë mjeku e jo teknikët. Përkundër kësaj unë kam kërkuar që të merren masa.

**Znj. Lirie Gashi:** Përshëndetje. Kam një pyetje për drejtorin e shëndetësisë: Para disa muajve na keni premtuar se në QKMF në stomatologji do të vijë material për trajtime. A kanë filluar këto shërbime?

**z. Agron Bacaj, drejtor I shëndetësisë:** Ne jemi duke pritur procedurat për furnizim me atë material të nevojshëm. Kur të fillojnë procedurat e prokurimit në muajin shkurt do të furnizohemi me materialin e nevojshëm për ato shërbime në stomatologji.

**Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrthimi dhe miratimi I rekomandimeve të KPF-së.**

**Me 22 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUAN në pako rekomandimet.**

**Pika 5 e Rendit të Ditës: Shqyrthimi dhe miratimi I propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2024.**

**z. Enver Berisha, drejtor I FE Zh:** Përshëndetje të gjithëve. Sikurse edhe vitin e kaluar edhe këtë vit kemi pasur tejkalime të të hyrave vetanake. Bartjen e këtyre mjeteve shtesë kemi menduar që të I ndajmë në dy kategori. 150 mijë euro të ndahen për shujtat e punëtorëve, këtë kemi marr vendim me kryetarin dhe bordin. Pra ju kisha lutë që të miratojmë vendimin e parë e

më pastaj të kalojmë në pjesën tjetër, ku janë shpenzime kapitale dhe mjetet të ndara nëpër projekte.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Ta kemi parasysh se ne nuk jemi duke ndryshuar vendimin por vetëm vlerën e shujtës nga 2.5 euro në 4 euro.

**z. Esat Raci:** E përkrahim këtë propozim për ndarjen e shujtave për shërbyesit civil për vitin 2024. Dua të dij se çfarë është bërë për ndarjen e shujtave të më hershme sepse një pjesë e punëtorëve kanë marr shujtat ndërsa një pjesë tjetër jo.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Është vendim I gjykatës që ne nuk mund të interferojmë. Kemi menduar që të harmonizojmë mundësitë buxhetore që kemi dhe kemi biseduar edhe me sindikatën që tutje të ndalen procedurat në gjykata. Për këtë rast, mendoj që nuk do të na kthejnë negative ligjshmërinë. Tani kemi mundësinë sepse kemi tepricë buxhetore e si të tillë e kemi orientuar. Të shohim se a po kalon. Punëtorët e administratës janë më të merituarit dhe kanë nevojë më së shumti.

**z. Enver Berisha, drejtor I FEZH:** Sa I përket gjykatave, tre vendime kanë ardhë për një temë të vetme. Një vendim për disa drejtori ka ardhur pozitiv për shujta, një tjetër negative dhe një tjetër për rishikim.

Kryesuesi tha se ekzekutivi ka mundur ta ekzekutoj vendimin për shujta në vlerë prej 2. 5 pa ardhur në kuvend fare por shuma 2.5 tani më është shumë e vogël dhe asnjë shujtë nuk mbulohet.

#### **Me 21 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

Vendimi I dytë kishte të bënte për ndarjen e mjeteve që drejtori e tha më herët dhe u vu në votim

#### **Me 21 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.**

#### **Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi I raportit të menaxhimit financiar Janar- dhjetor 2024.**

**z. Enver Berisha, drejtor I FEZH:** Unë do ta bëjë një hyrje gjithsesi përndryshe materialin anëtarët e kuvendit e kanë marrë me kohë. Planifikimi I buxhetit ka qene 15 milion e 866 mij e 596 euro, për vitin 2024 dhe këto janë ndarë në kategori si çdo herë.

Drejtori Berisha foli për grandet, të hyrat vetanake, të hyrat e bartura. Planifikimet dhe shpenzimet. Ai bëri krahasime në mes të planifikimeve dhe shpenzimeve dhe tregoj me shifra se sa janë shpenzuar, duke thënë në fund se projektet e planifikuara janë realizuar në 97. 12% duke e mbyllur me deklaratën se nuk beson që ka komunë në Kosovë që ka arritur këtë përfomancë.

**z. Zafer Gashi:** Ajo që e pashë, pasi I pashë disa sqarime që keni dërguar më vonë, dua të ju [pyes për disa gjera. E përmendet buxhetin I cili fatmirësish është përkrahë nga grandet qeveritare por të hyrat vetanake shihen se janë më të vogla krahasuar me vitin e kaluar. Tek tabela 3 tatimin në pronë e ke më të zvogëluar. Tek taksat për leje ndërtimi ka zvogëlim gjithashtu. Përkundër sa ndërtimet e larta janë bërë dhe sa lejet I keni dhënë, taksat janë më të vogla se sa në vitin 2023.

**z. Gashi foli për shpenzimet e bëra për sektorë të ndryshëm duke krahasuar me vitin 2023. Ai u ndal tek shërbimet shëndetësore, këshilluese, shërbimet e veçanta konsultative, shërbimet e shtypit, kontraktuese, teknike, anëtarësim, shërbimet për varrime etj. Z. Gashi duke bërë llogaritje të shpenzimeve kishte vërejtje tek mirëmbajtjet e mobileve, servisimin e aparatit të zjarrfikësve etj. "Ajo që më pëlqeu ishte 73-transferet sociale për individ por a mund të ma shpjegoni 75- transferet përfitime individuale të tjera, çka janë gjithë këto mjete" tha z. Zafer Gashi në fjalën e tij.**

**z. Enver Berisha, drejtor I FEZH:** Në një farë forme po më vjen befasi pse nuk e keni hapur materialin dhe ta lexoni sqarimin. Shifrat që janë nuk ndryshojnë, për cilëndo kategori shpenzimi I ke sqarimet në detaje. 75 është kategori subvencione, njerëz që aknë problem me shëndet, shpenzimet për vdekje dhe varrime dhe për lindjet. Tek pjesa e inventarit ajo që ngrite si shqetësim ka të bëjë me tabelat e mençura që jemi furnizuar.

**z. Zenun Elezaj, kryetar I komunës:** Tek pika 9 janë shtesat e pagesa te rregullta vlera 38 mijë, është pagesa për KPF, Komiteti I auditimit dhe komiteti për komunitete. Pastaj është Pika 12 kujdestaria që është zjarrfikësit, kujdestaria në shëndetësi, zëvendësimi I punëtorëve me sëmundje deri në procesin e rekrutimit. Shërbimet këshillëdhënëse është marrëveshje bashkëpunimi në një Projekt evropian. Shtypja për printim është shfrytëzimi I printerëve kontratë e AQP. Pika 28 sipas planit kontabël pjesa më e madhe është regjistruar asgjësimi i barnave, dekorimi I qytetit, dezinfektimi I çerdheve etj. Pika 32 Furnizimi me tabela të mençura, furnizimi me inventar nëpër shkolla. Pika 75 Shpenzimet e ujit. Ndërhynë zyrtarja e Financave me kërkësë të kryetarit:

**znj. Melihate Behramaj, ZKF:** Tek shpenzimet kontraktuese të tjera hynë transporti I nxënëseve. Furnizimi me tabela janë në dy vende ; një pjesë është blerë nga mallrat dhe shërbimet sepse me tender çmimi ka dalë më pak se 1000 euro, ndërsa në kodin e projekteve kapitale, çmimi për njësi ka dalë më shumë se 1000 euro me tender prandaj jemi detyruar të bëjmë pagesën nga ky kod dhe për këtë arsy janë në dy tabela këto shpenzime.

**z. Ndrec Zefaj:** Lidhur me raportin finansiar dëshiroi të diskutoj dy çështje që kanë të bëjnë me shpenzimet kapitale dhe të hyrat vetanake. Krahasuar me vitin 2003 kemi të hyra më pak në 2024, shpresoj që të përmirësohet kjo. E dyta, shpenzimet kapitale: Nga buxheti I tërësishëm për këtë kategori 4 milion e 987 mijë euro, janë shpenzuar 4 milion e 605 mijë euro që diferenca është 382 ijinë euro që kemi një jo efikasitet I shpenzimeve në këtë kategori.

**z. Enver Berisha, drejtor I FE Zh:** Kemi një sfidë në të hyrat vetanake këtë vit. Komuna ka ngrit shqetësim për këtë kryesisht tek tatimi në tokë. Këtë e kemi diskutuar edhe me auditorin sepse ka plotë pronar që janë pronar të shtëpive por jo edhe I tokës. Ky problem nuk është vetëm në Klinë por në të gjitha komunat. Përkundër faktit që ne I kemi rritë të hyrat derisa të bëhet një zgjidhje në tërësi për problemin që e kemi kjo gjendje është kështu siç është.

**z. Valmir Bacaj:** Ne si grup kuvendar e kemi pranuar raportin finansiar si dhe analitiken. Në bazë të këtij reporti buxheti për vitin 2024 ka qenë më I lartë për 1. 92% prandaj kemi edhe rritje të shpenzimeve. Grandi I të hyrave vetanake krahasuar me vitin paraprak ka pasur rritje 4.55% po ashtu tek përforma e shpenzimeve kemi pasur progres 97.12% realizim. Ndikim në rritjen

e shpenzimeve tek kategoria paga dhe mëditje ka pasur rritja e koeficientit si dhe përvoja e punës. Rritja tek komunalitë ka pasur ndikim zgjerimi I rrjetit të ndriçimit publik si dhe ajo e pompave termike. Ne si grup kuvendar e konsiderojmë raport pozitiv.

**Z. Armend Beqiri:** Përshëndetje. Do të doja të ndalem tek shpenzimet Komunali. Rritja ka ardhë si pasojë e instalimeve të pompave termike. Investimi në pompat termike, është investimi më I mirë që komuna e ka bërë, kjo quhet edhe green energy, vlerën e instalimit e ka të lartë por më pastaj ky investim kthehet pasi që shpenzimet I kanë të vogëla. Do të kemi edhe mbrojtje të ambientit. Shpresoj që investimi I komunës në këtë fushë të vazhdoj edhe më tutje.

**Pika 8 e Rendit të Dites: Shqyrtimi I raportit nga procesi I organizimit të konsultimit publik për draft planin lokal të veprimit në mjedis 2025-2030.**

Kryesuesi tha se po e votojmë njëherë procesin e organizmit.

**Me 16 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 9 e Rendit të Dites: Shqyrtimi dhe miratimi I draft planit lokal të veprimit në mjedis 2025-2030**

**Znj. Xhezide Trepça-Gashi, zyrtare:** Përshëndetje të gjithëve. Plani Lokal I veprimit është hartuar nga krupi punues I caktuar nga kryetari. Janë mbajtur tri punëtori dhe aktivitete për ta hartuar këtë plan. Ky plan është dokument planifikues strategjik dhe ka për qellim përmirësimin e gjendjes së mjedisit në territorin e Komunës. Ka një rendësi të veçantë për komunën dhe është obligim ligjor që ta kemi këtë plan.

Znj. Gashi në vazhdim foli për rëndësinë, qëllimin dhe gjithë atë që është bërë për hartimin e këtij plani të veprimit në mjedis, duke thënë në fund se duke e ditur rëndësinë e këtij plani përuajtjen e mjedisit në komunën tonë ju ftoj që të votoni.

**Z. Zafer Gashi:** E kam lexuar me vëmendje dhe ky plan për këtë periudhë kohore është më rëndësi për Klinën. Që në fillim do të mundohem që në disa vende të jap opinionet e mia. U tha që është grup I caktuar nga kryetari por pa dashur që të bëjë notim të këtyre njerëzve të grupit, përvèç z. Rexhep Rexhepi, mendoj se të tjerët nuk janë të profesionit adekuat. Është dashur te jetë edhe ndonjë tjetër profesionist i ambientit. Ajo që keni shkruar në disa vende duket të jetë më shumë konstatime se si është gjendja por pa dhënë masat që do të merren. Në lidhje me ndotjen e ajrit ju keni shkruar saktë se çka e ndotë ajrin por nuk keni shkruar se çfarë do të ndërmerret për përmirësimin e cilësisë së ajrit.

**Z. Zafer Gashi** foli tutje edhe për ndotjen e rrezikshme të ajrit në lokalitetin e Sferkes dhe përreth dhe pyeti se çfarë do të ndërmerret. Ai po ashtu kërkoj që të saktësohet se kush do të I financoj këto aktivitete që duhet të impelmentohet ku sipas shkrimit thuhet se për implementimin e tyre për 5 vjet kërkohen investime vetëm nga komuna pa donator kërkohen 10 milion e 200 mijë euro. Z. Gashi tha se vetëm për çështje lokale që keni me ju dhënë kontrata njerëzve, vetëm për projekte pa zbatime vlerën prej 535 mijë euro dhe sipas z. Gashi është shumë e madhe.

Në fund z. Zafer Gashi tha se e vlerëson si ide dhe mendon se ky plan është I mirë e I dobishëm por që duhet edhe njëherë të rishkruhet pasi të analizohet mirë nga ekspertë të fushës.

**z. Kolë Prenaj:** Përshëndetje. Shumë është me rëndësi që të punohet në planin e veprimit në ambient. Klina është një qendër që bëhen shumë shkarkime të ujërave të zeza edhe nga qytetet e tjera. Zonat me të rrezikuara janë zonat e Rastokave dhe të qendrës së qytetit. Është mirë të punohet në standardizim të punës sonë. Pra, shkarkimi I ujërave të zeza të jenë standard në bazamentin e parë. Në këtë drejtim nuk mund të intervenojmë ne nëse nuk intervenon qeveria në ndërtimin e impianteve të ujërave të zeza. E përgëzoj planin, është I punuar mirë por kujdesi më I madh të jetë në qytet.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Këtë plan pas miratimit do të mundohemi ta përfshijmë në buxhetet e ardhshme. Ne do të jemi prap ata që do ta votojmë financimin e këtij plani të veprimit në një kod të veçantë. Do të mundohem që ky projekt të financohet kryesisht nga donatorët sepse buxheti I komunës është I pamjaftueshëm. Pra, nuk do të thotë që ky projekt do të mbështetet nga buxheti I komunës, shumë pak do të mbështetet financiarisht nga buxheti I jonë, ka shumë donator që do të financojnë.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Atë që e tha Kola, është shqetësim. Unë e kam konsultuar shumë këtë plan të veprimit por absurd i është të mos harmonizimi I ligjeve që bijën ndesh me njeri tjetrin dhe nuk e dimë se si të veprojmë. Shembull tek ndotja e lumenjve, ligji për mbrojtjen e ujërave, shembull çka është SHKARKIMI? Ligji thotë: Shkarkimi I ujërave të ndotura të trajtuar ose të pa trajtuar të ujërave të përdoruara te kanalizimeve etj. Te I njëjtë ligj gjobat për të gjithë këta që cilësohen si ndotës janë: Për personin fizik që derdhin ndotës në lumenj janë 5.000 deri në 20.000 euro ndërsa personi juridik dënohet nga 50.000 deri në 100.000 euro. S' ka komunë që nuk I derdh ujërat e zeza në lumenj, d.m.th. nuk ndotin lumenjtë. Parlamenti në momentin e aprovimit të këtij ligji e ka ditur që do të shkelet.

**Me 19 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim U MIRATUA.**

**Pika 10 e rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I procesverbalit nga mbledhja e dytë e kryetarit me qytetarë për vitin 2024.**

**Me 19 vota për asnjë kundër dhe një abstenim U MIRATUA**

**Pika 11 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I propozim vendimit për shtim të buxhetit për participim lidhur me projektin për shpërndarje të makinerive bujqësore-multikultivator me frezë.**

**z. Esat Raci:** Ne vazhdimisht kemi qenë për shtimit të buxhetit për këtë aspekt por vazhdimisht kemi thënë se ka pasur ndarje jo të mira, kemi transmetuar atë që e aknë thënë qytetarët. Në ndarjen e fundit kam info që s' ka pas auditim, s' ka pasur komision mbikëqyrës. Mendimi im është se ka qenë ndarje para politike. Ne përsëri do ta votojmë këtë shtim por kërkojmë që komisionet të jenë nga drejtoria e bujqësisë që e njohin këtë punë.

**Me 20 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 12 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi I raportit të punës së KKSB-së si dhe raportit të komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave.**

**Znj. Marqe Selmani, nënkryetare e komunës,** raportoi në detaje për të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2024 që KKSBB ka realizuar. Foli për problemet e evidentuara, ndërhyrjet, sfidat dhe situatën e tanishme.

**z. Tunë Dedaj:** Faleminderit për raportin por mendimi im për siguri është se nga qentë endacak fëmijët tanë nuk guxojnë me ardhë në shkollë vet. Kërkoi që të I bëhet thirrje qeverisë që të bëhet zgjidhje sepse nuk është zgjidhje ajo që po I behet geneve endacak deri me tani. Propozoni qeverisë që të ndaj mjete që këta qenë endacak të grumbullohen dhe të mbahen të izoluar.

Për raportin e komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave kryesuesi tha se është e këshillueshme që të merret një vendim formal që të kompensohen anëtarët e këtij komisioni me vlerën 50 euro për person për çdo mbledhje që aknë mbajtur.


**z. Tunë Dedaj:** Duke e marrë parasysh që ky komision ka punuar në mënyrë të shkëlqyer dhe ka pasur punë të mundimshme, propozoj që kjo shumë të rritet nga 50 në 80 euro.

**Shuma prej 50 euro për kompensim për anëtarë të komisionit u vendos në votim dhe me 20 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

Vendimi I anëtarëve të kuvendit për kompensimin e anëtarëve të komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave ishte edhe e fundit nga zhvillimet e punimeve të mbledhjes së kuvendit. Kryesuesi e shpalli të mbyllur seancën.

**Procesmbajtës:**

**Skënder Behramaj**



**Kryesuesi:**

**Fadil Gashi**

